



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRN

02 Nr. / Br. 1007/20  
Nr. i fq. / Dr. sh. - 02 -  
Data: / Datum: 02.11.2020  
VUSHTRRI - VUCITRN



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIC OF KOSOVA/REPUBLIKA KOSOVA  
**KOMUNA VUSHTRRI**  
VUSHTRRI MUNICIPALITY /OPSTINA VUCITRN

Në bazë të nenit 11 dhe 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, dhe nenit 4, dhe neni 10 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, si dhe nenit 67 "g" të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës si organ shpronësues me datën 02.11.2020 merr këtë:

## VENDIM PRELIMINAR

### Neni 1

**KONSTATOHET** se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1 deri 1.4, paragrafi 1 i nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010, për shpronësimin e pronës së paluajtshme për qëllim të përfitimit të ligjshëm publik-realizimi i projektit për rregullimin dhe zgjerimin e rrugës "2 Maji" në Vushtrri, Komuna Vushtrri për pjesën e parcelave kadastrale si në vijim:

P-70202016-03022-2, në sipërfaqe prej 22 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 963 m<sup>2</sup>, ZK-Vushtrri, pronar në pjesë ideale 1/1 Ismet (Idriz) Kurti nga Vushtrria, Komuna Vushtrri.

P-70202016-03023-0, në sipërfaqe prej 58 m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1963 m<sup>2</sup>, ZK-Vushtrri, pronar në pjesë ideale 1/1 Halim (Muharrem) Selaci nga Vushtrria, Komuna Vushtrri.

### Neni 2

Brenda 5 ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, do të njoftohet me vendimin preliminar pronari/zotëruesi i interesit të pronës e cila do të shpronësohet.

### Neni 3

Brenda 10 ditëve të punës pas miratimit, vendimi preliminar do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në Gazetën ditore "Zëri" në Kosovë.

#### Neni 4

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë brenda 15 ditëve pas hyrjes në fuqi, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, konform nenit 35 paragrafi 3 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Nr. 03/L-139 me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr.03/L-205 të datës 28.10.2010. Ankesa mund të paraqitet nga pronari ose zotërues i interesit në pronën e prekur nga ky vendim. Në të njëjtën ditë në të cilën dorëzohet ankesa në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të organit shpronësues (Komunës së Vushtrrisë) 5 (pesë) kopje të sakta dhe të plota të ankesës, duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse që e arsyetojnë ankesën.

#### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare dhe në Gazetën ditore "Zëri" në Kosovë.




Kryetari i Komunës

Xhafer Tahiri



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN	
02 Nr. / Nr.	1007/20
Nr. i fq. / Br. sh.	- 02 -
Data: / Datum	02.11.2020
VUSHTRRI - VUÇITRN	



**REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI**  
**REPUBLIKA KOSOVA - OPŠTINA VUÇITRN**

Na osnovu člana 11 i 13 Zakona o Lokalnom Samoupravljanju br. 03/L-040, člana 4, i člana 10, Zakona o Ekspropriaciji Nepokretne Imovine Br. 03/L- 139 sa izmenama i dopunama Zakona Br. 03/L-205 dana 28.10.2010 god, kao i člana 67 "g" Statuta Opštine, Predsednik Opštine, kao eksproprisani organ dana 02.11.2020. god, donosi ovu:

**PRELIMINARNU ODLUKU**

**Član 1**

**UTVRĐENO** da su ispunjeni uslovi navedeni u narednim paragrafima 1.1 do 1.4, paragraf 1, član 4 Zakona o Ekspropriaciji Nepokretne Imovine br. 03/L-139 sa izmenama i dopunama Zakona Br. 03/L-205 od dana 28.10.2010 god, o ekspropriaciji nepokretne imovine, u cilju zakonske javne koristi, realizaciji projekta o regulaciji i proširenje puta "2 Maj" u Vuçitrn za deo katatarske parcele kao što sledi :

- P-70202016-03022-2 , u površini od 22m<sup>2</sup>, od ukupne površine od 963 m<sup>2</sup>, KZ-Vuçitrn , sa vlasnikom na idealnom delu 1/1 Ismet (Idriz ) Kurti iz Vuçitrna, Opština Vuçitrn.
- P-70202016-03023-0 , u površini od 58 m<sup>2</sup>, od ukupne površine od 1963 m<sup>2</sup>, KZ-Vuçitrn , sa vlasnikom na idealnom delu 1/1 Halim (Muharrem) Selaci iz Vuçitrna, Opština Vuçitrn

**Član 2**

Unutar 5 radnih dana posle usvajanja ove odluke, biće informisan preliminarnom odlukom vlasnik/nosilac imovine koja će se eksproprisati

**Član 3**

Unutar 10 radnih dana posle usvajanja,preliminarna odluka biće objavljena na Službenom Listu Republike Kosova i na Dnevnom Listu "Zeri" na Kosovu.

#### Član 4

Protiv ove odluke može se podneti žalba unutar 15 dana posle stupanja na snazi , u Opštinskom Sudu u Mitrovici Grana u Vučitrnu, u skladu člana 35 paragraf 3, Zakona o Eksproprijaciji Nepokretne Imovine Br 03 L/139 sa izmenama i dopunama Zakona br.03/L-205 dana 28.10.2010.god.

Žalba se može podneti od vlasnika ili nositelja interesa po ovoj odluci. U istom danu kada se predaje žalba u Sudu, podnosilac žalbe treba odmah i direktno predati u Zakonskoj Kancelariji organa eksproprijacije (Opštini Vučitrn) 5 (pet) tačnih i punih kopija žalbe, uključujući sve prateće dokumentacije koji opravdavaju žalbu.

#### Član 5

Odluka stupa na snagu danom objavljivanja na Službenom listu i na Dnevnom listu "Zeri " na Kosovo.

  
**Xhafer Tahiri**  
**Predsednik Opštine**

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRRI

02 Nr./Br. 1007/20  
Nr./Rq./Dit. 02  
Data/Date 02.11.2020  
VUSHTRRI - VUÇITRRI

Translated: Albanian-English

/RKS-Logo/  
REPUBLIC OF KOSOVO

/Municipality -logo/  
MUNICIPALITY OF VUSHTRRI

Pursuant to Article 11 and 13 of the Law on Local Self-Government no. 03 / L-040, and Article 4, Article 10 of the Law on Expropriation of Immovable Property, No. 03 / L-139 with the amendments and supplements to the Law No.03 / L-205 dated 28.10.2010, as well as article 67 "g" of the Municipality Statute, the Mayor as an expropriating body on 02.11.2020 receives this:

### PRELIMINARY DECISION

#### Article 1

It is CONCLUDED that the conditions set out in sub-paragraphs 1.1 to 1.4, paragraph 1 of Article 4 of the Law on Expropriation of Immovable Property, No. 03 / L-139 with amendments and supplements to Law No. 03 / L-205 dated 28.10.2010, on the expropriation of immovable property for the purpose of lawful public benefit - implementation of the project for the regulation and expansion of the road "2 May "In Vushtrri, Municipality of Vushtrri for the part of cadastral parcels as follows:

P-70202016-03022-2, in area of 22 m<sup>2</sup>, from the total area of 963 m<sup>2</sup>, CZ-Vushtrri, owner in ideal parts 1/1 Ismet (Idriz) Kurti from Vushtrri, Vushtrri Municipality.  
P-70202016-03023-0, in area of 58 m<sup>2</sup>, from the total area of 1963 m<sup>2</sup>, CZ-Vushtrri, owner in ideal part 1/1 Halim (Muharrem) Selaci from Vushtrri, Vushtrri Municipality.

#### Article 2

Within 5 working days after the approval of this decision, the landlord / owner of the property interest will be notified with the preliminary decision which will be expropriated.

#### Article 3

Within 10 working days after the approval, the preliminary decision will be published in the Official Gazette of the Republic of Kosovo and in the daily newspaper "Zeri" in Kosovo.

#### Article 4

This decision may be appealed within 15 days after the entry into force, the Basic Court in Mitrovica branch in Vushtrri, pursuant to Article 35 paragraph 3 of the Law on Expropriation of Immovable Property, no. 03 / L-139 with amendments and supplements to Law No. 03 / L-205

ZYRA PËR PERKTHIME GJUHËSORE  
INTERNATIONALES ÜBERSETZUNGSBÜRO  
INTERNATIONAL TRANSLATION OFFICE  
INTERNATIONAL DE TRADUCTION BUREAU  
MEĐUNARODNI KANCELARIJA ZA PREVOĐENJE

Adresse :Sheshi Hasan Prishtina, 42000 Vushtrri, nr.114,Kosovë, tel : +383 44 434 814, e-mail : [ss.law@live.com](mailto:ss.law@live.com)

Professional Translator, TTF-Office  
Mr.Sc. Skender Spahiu /Lawyer / Jurist i dip.  
License no. 7430

dated 28.10.2010. Complaints can be filed by the owner or holder of interest in the property affected by this decision. On the same day on which the appeal is submitted to the Court, the complainant must immediately and directly submit to the legal office of the expropriating body (Municipality of Vushtrri) 5 (five) accurate and complete copies of the appeal, including all accompanying documents justifying the complaint.

Article 5

The decision enters into force on the day of its publication in the Official Gazette and in the daily newspaper "Zeri" in Kosovo.

  
Mayor  
  
Xhafer Tahiri



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIŠË-OPËSTINA VUÇITRRI

02 Nr./Br. 1034/20

Nr. i fq./list. \_\_\_\_\_

Data: / Datum 09.11.2020

VUSHTRRI - VUÇITRRI



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Task-Forca për veprim gjatë pandemisë COVID-19

Bazuar në Udhëzuesin e MASH-it për organizimin e mësimin në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID-19, Task-Forca komunale për veprim në kushtet e pandemisë në arsimin e Komunës së Vushtrrisë, në takimin e mbajtur në distancë me datën 05.11.2020, merr:

V E N D I M

1. Në shkollat fillore: "Ali Kelmendi" dhe "Andon Zako Çajupi" në Vushtrri, si dhe Çerdhen e Fëmijëve "Foleja" në Vushtrri, nga dita e hënë, datë 09.11.2020 të aplikohet vijueshmëria e mësimin të rregullt në shkollë, sipas skenarit A, duke qenë se kanë kaluar dy javë nga dita e mësimin në distancë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi duhet të kujdeset Drejtoria për Arsim.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi pushon të vlejë vendimi Nr. 950/20, datë 19.10.2020 dhe vendimi Nr. 967/20, datë 22.10.2020.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës –  
Kryesues i Task-Forcës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- Arkivit të Sekretarisë.



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1096/20

Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_

Data: / Datum 16.11.2020

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI


Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, si dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë së Kosovës, nr. 01/42, dt. 11.11.2020, lidhur me situatën e krijuar pas shtimit të rasteve të infektimit me virusin COVID-19, si dhe rrezikun e përhapjes së kësaj pandemie edhe në administratën e komunës, Kryetari i Komunës pas konsultave me anëtar të Shtabit Emergjent për Mbrojtje nga virusi COVID-19 me datën 16.11.2020, merr këtë:

### V E N D I M

Për ndërmarrjen e masave preventive për mbrojtje nga korona virusi te zyrtarët e komunës si vijon:

1. Urdhërohen |Drejtorët te Drejtorive dhe mbikëqyrësit e drejtpërdrejtë që të reduktojnë stafin e punës në staf esencial për punë – të hartojnë listat e punëtorëve sipas orarit të cilin do ta përpilojnë varësisht prej nevojave për kryerje të punëve të domosdoshme dhe dërgojnë: një kopje Kryetarit të Komunës dhe një kopje Udhëheqësit të Personelit.
2. Drejtorët e drejtorive të pezullojnë për 14 ditë punën me palë përveç Drejtorisë për Administratë – sektorin e gjendjes civile në të cilin do të reduktohet nr. i zyrtarëve ofiqarë – të punojnë me radhë sipas orarit të përcaktuar paraprakisht.
3. Obligohet Udhëheqësi i Personelit që ti njoftoj me kohë zyrtarët përgjegjës të komunës me përmbajtjen e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit,
5. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të komunës.



Xhafer Tahiri

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Menaxherit të Personelit
- Zyrës për Informim
- Arkivit të Sekretarisë